



ZYRA E PROKURIMIT

Nr 072/2021

Nr. Protokoli: 108/2021

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik FLO-CO SH.P.K., AGE group SH.P.K., Semetisht, 23000, Suhareke
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	15.07.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar ne Plateforme Elektronike te dates 13.07.2021 , të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: **Grup i Operatorëve Ekonomik FLO-CO SH.P.K., AGE group SH.P.K., Semetisht, 23000, Suhareke**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Zhvillimi i turizmit rural Guida digjitale dhe shtegu i ecjes-Mushtisht, Delloc** me Nr. të Prokurimi: **624-21-3054-5-2-1 & 624-624-021-090-521** nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e datës 13.07.2021 te parashtruar nga Operatorët Ekonomik:: **Grup i Operatorëve Ekonomik FLO-CO SH.P.K., AGE group SH.P.K., Semetisht, 23000, Suhareke** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Zhvillimi i turizmit rural Guida digjitale dhe shtegu i ecjes-Mushtisht, Delloc** kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të 08.07.2021 të publikuar në platformen elektronike.
2. **Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 08.07.2021 .**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë **13.07.2021**, ka pranuar kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Zhvillimi i turizmit rural Guida digjitale dhe shtegu i ecjes-Mushtisht, Delloc** me Nr. të Prokurimi: **624-21-3161-1-3-6& 624-021-092-136** kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të dates, **08.07.2021** të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik gjatë vlerësimit të tenderëve, dhe se komisioni për vlerësim dhe krahasim të tenderëve ka vlerësuar drejt, duke analizuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar dhe se pretendimet tuaja nuk qendrojnë, ngase OE I shpallur per fitues është në marrveshje per shlyerje te obligimeve ndaj ATK-se, bazuar te interpretimit I KRPP-se te pytjet e shpeshta, saktesisht te pyetje 64, ku thuhet . *A duhet OE me rastin e dorëzimit të ofertës të dëshmojnë se nuk janë në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së? Nisur nga fakti se shume OE kane marrëveshje për shlyerje te borxheve me ATK-ne, KRPP sqaron se edhe ne këtë rast marrëveshjet për shlyerje te borxheve duhet te jete para datës se publikimit të njoftimit të kontratës.*

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shefi i Prokurimit  
Armin BYTYQI

